

MENAXHIMI

Përshkrimi i kursit

Ky kurs trajnimi është hartuar me qëllim që të theksojë rolin e menaxhimit në ofrimin e një shërbimi më cilësor për konsumatorët. Kursi do të trajtojë çështje që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e përditshme të menaxherëve si komunikimi, krijimi dhe menaxhimi i ekipeve, zgjidhja e problemeve dhe marrja e vendimeve.



Pjesëmarrësit do të pajisen me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përballuar sfidat e përditshme dhe për të përmirësuar performancën e shoqërive që drejtojnë.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs trajnimi mbi menaxhimin është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për drejtorët e përgjithshëm të shoqërive ujësjellës kanalizime, drejtorët teknik dhe menaxherët.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Komunikoni në mënyrë efektive;
- Identifikoni karakteristikat kryesore të një drejtuesi efektiv;
- Përzgjidhni dhe përdorni stile efektive të menaxhimit;
- Krijoni dhe drejtoni ekipe;

- Hartoni plane afatgjata dhe afatshkurta për të përbushur misionin e shoqërisë;
- Vendosni qëllime dhe objektiva për zbatimin e planeve tuaja;
- Përdorni teknika specifike që ndihmojnë në njohjen e hershme të problemeve;
- Analizoni problemet duke përdorur një shumëllojshmëri teknikash;
- Punoni vetëm apo si pjesë e një ekipi për të krijuar një listë gjithë përfshirëse të zgjidhjeve të mundshme të problemeve;
- Përdorni mjete dhe teknika për të marrë vendime efektive;
- Komunikoni me grupet e njerëzve që ka më shumë gjasa të ndikohen nga vendimi para dhe pasi të merret ai;
- Mbani nën vëzhgim perspektivën finaciare të shoqërisë.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në PowerPoint, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit "Menaxhimi". Përpos kësaj, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 22,000 lekë për person.

Jo-anëtarët: 25,000 lekë për person.

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.